



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1271/2 prot

Datë 05.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT TË OPERATORIT EKONOMIK
ANKIMUES DHE PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sead - SGS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-62788-03-17-2023, me objekt: “*Blerje ushqime*”, me fond limit 10.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra e Zhvillimit Shkodër.
- Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Sead - SGS” SHPK
Lagja 2, Rruga “Mullishtër”, Godinë 1 katëshe, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra e Zhvillimit Shkodër
Lagja “Skenderbeg”, Rruga “Dr. Ali Spahija”, Shkodër
- Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK
Rruga “Ing. Gjovalin Gjadri”, nr pasurisë 14/202, zona kadastrale 8593, Shkodër

Në datën 02.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr.1271 prot., datë 02.06.2023 e operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK për procedurën e prokurimit

“Procedurë e hapur”, me Nr. REF-62788-03-17-2023, me objekt: “Blerje ushqime”, me fond limit 10.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra e Zhvillimit Shkodër.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

“1. Ne lidhje me piken 2.3.1 të kapacitetit Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, Per kontratat nr 127 vitit 2022 dhe 345 viti 2021 jane ne kundërshtim me piken 2.3.1 pasi nuk ka paraqitur vërtetim nga Enti public bashkëgjatur faturat tatimore. Me qëllimverifikimi të përmbushjes së kontratës si dhe produktet që janë levruar.

2. Nuk ka deklaruar në QKB kontratën nr.127 viti 2022 me Drejtorinë e Cerdheve dhe Kopshteve, Bashkia Shkoder si NIPT dytesor dhe nuk ka deklaruar taksat vendore të Bashkisë Shkoder për vitin 2022.

3. Sipas pikës 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe dëshmitë e testimeve zyrtare të dorëzuara në SPE. Mostrat e kërkuara do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor. Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të cilat përmbajnë elementet: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik. U konstatua se dy nga mostrat e paraqitura (djathtë i bardhë dhe berxolle derri) nuk ishin sipas specifikimeve teknike në DST.

4. Sipas pikes 2.3.5 Operatori ekonomik i shpallur fitues përpara lidhjes së kontratës ka detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, nga verifikimi i korrespondences me AKU per inspektimin e fundit deri ne ditën e pranimit të ofertave 11/04/2023 rezulton qe kontrolli i fundit i subjektit është bere me dt 23/01/2023 nr.prot 147/1 ku rezulton objekti i aktivitetit mbyllur (fizikisht) dhe nr.depozituar ne QKB ishte jashte sherbimit. Subjekti ka paraqitur si akt inspektimi te fundit aktin nr. 820/1 dt 28/04/2022 qe nuk është i fundit i kerkuar nga ana jone.”

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “EL-GJO-2006” pjesmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje të kriterëve si më poshtë:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate ne një vlere prej 4,000,000 (katër milion) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Fletë-analiza per të gjithë artikujt ushqimor që prokurohen nga një laborator i autorizuar i kontrollit ose i referencës ku të përfshihen të gjithë treguesit e përcaktuar në specifikimet teknike.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqesë një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor dhe dëshmitë e testimeve zyrtare të dorëzuara në SPE. Mostrat e kërkuara do paraqiten ne datën dhe oren e hapjes se ofertave, prane Autoritetit

Kontraktor.Mostrat e kerkuara duhet te jene nje etikete e cila te permbaje elementet: moster “emri i artikullit”, daten e zhvillimit te tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulen e operatorit ekonomik. Mungesa e mostres eshte kusht skualifikues.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit nga autoriteti kontraktor.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 05.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri